

Syllabus i lëndës

Lënda: FIK'H - IV (E Drejta Penale)

Programi i studimit: Teologji Islame

Numri i ECTS kredive: 5 ECTS Kredi

Niveli dhe lloji i lëndës: Obligative

Kodi i lëndës: 409

Fondi i orëve: 2+2 (Semestri VIII)

Mësimdhënësi: Prof. ass. Dr. Shefqet Krasniqi

Qëllimi i lëndës

Qëllimi i kësaj lënde është njohja me dispozitat e së drejtës penale, gjegjësisht me çështjet që kanë të bëjnë me pjesën e dytë të së drejtës penale e që është gjykata dhe dispozitat që ndërlidhen me gjyqësinë. Përmban një grumbull dispozitash legjislative që ndërlidhen me drejtësinë, në mënyrë që të sjell qetësi dhe siguri, e për të forcuar lidhjet mes individëve dhe mes sunduesit dhe popullit.

Përmes së drejtës penale, rregullohen raportet mes individëve, shoqërisë dhe shtetit, e tëra kjo bëhet me qëllim që të ruhet qetësia, rendi dhe stabiliteti.

Përmes kësaj lënde synohet të ngritën debate dhe diskutime që do ta ngjallin kërkuesin e studentit. Shpjegimi i lëndës do të bëhet në formë interaktivi mes ligjëruesit dhe studentëve, në mënyrë që studentët të jenë pjesëmarrës aktiv në secilën temë.

Rezultatet e pritura të nxënies:

Pas përfundimit të lëndës (kursit), studenti do të jetë në gjendje:

Të pajiset me njohuri të përgjithshme për përmbajtjen e së drejtës penale.

Të krahasoj mendimet e ndryshme të shkollave juridike për dispozitat e së drejtës penale, sikurse që të krahasoj ligjin islam e së drejtës penale me atë laik të kodit penal.

Të diskutoj rreth çështjeve të ndryshme të së drejtës penale.

Të mbroj mendimet dhe qëndrimet e të gjitha shkollave juridike, ashtu siç i mbrojnë pasuesit e secilës shkollë juridike.

Të paraqes mendimin kritik ndaj çështjeve ku ai nuk pajtohet ndaj secilës shkollë juridike.

Të aplikojë njohuritë dhe shkathtësitë e fituara gjatë kursit, në jetën e tij.

Metodologjia e mësimdhënies:

Mësimi do të zhvillohet në formë të ligjëratave, ku do të bëhet stimulimi i studentëve në diskutime interaktive, në mënyrë që të bëjnë pyetje, të japin komente e të bëjnë analiza. Do të ketë edhe teste të vetëvlerësimit në raport me temat që do të shpjegohen. Studentëve do t'iu jepet mundësia që gjatë përgatitjes së lëndës apo seminareve, të kontaktojnë me profesorin dhe të marrin edhe sugjerimet e tij, për një sukses efikas dhe rezultat të duhur.

Përmbajtja e lëndës:

Java e parë: Njohja me syllabusin, informata të përgjithshme në lidhje me lëndën dhe procesin e lëndës përgjatë një semestri, njohje me veprat penale, synimin e lëndës etj.

Literatura: (Dr. Shefqet Krasniqi, *E drejta Penale Në Sheriatin islam, studime krahasimore me legjislacionin hebre, të krishterë dhe ligjet e Kosovës*. Material i përgatitur enkas për studentë të FSI-së (Kjo literaturë do të jetë bazë, ndaj në vazhdim do t'i referohemi vetëm përmendjes së faqes.)

Java e dytë: Hyrje, përkufizimi i krimit tek *fukahatë*, objektivat e ndëshkimeve për vepra penale, urtësitë e caktimit të veprave penale, klasifikimi i veprave penale, përkufizimi i *hududeve*.

Literatura: (fq. 1/32-62)

Java e tretë: Imoraliteti, *zinaja*. Përkufizimi i zinasë në sheriatin islam, kushtet e plotësimit të kësaj veprë; Çështje të ndryshme rreth zinasë; Dënimi i zinasë, *hadi*, në legjislacionet e mëhershme paraislame dhe dënimi i zinasë në sheriatin Islam; Masat ndëshkuese për raste të caktuara të imoralitetit në ligjet e Kosovës.

Literatura: (fq. 1/65-156)

Java e katërt: Akuzimi për Imoralitet, *el-kadhif*; Përkufizimi i akuzimit, kushtet e akuzimit, mënyra e vërtetimit të akuzimit; Ndëshkimi për akuzim tek legjislacionet e mëhershme dhe në fund në sheriatin Islam; Dënimi për shpifje në ligjet e Kosovës.

Literatura: (fq. 1/165-194)

Java e pestë: Alkooli, kushtet e ndalimit, mënyra e vërtetimit të kësaj veprë penale, masat ndëshkuese për pirje alkoolike; Substancat narkotike, historiku i tyre, dispozita e përdorimit të substancave narkotike, masat ndëshkuese për substanca narkotike; Dispozitat e pirjes së alkoolit

te hebrenjtë dhe të krishterët: Dispozita e pirjes së alkoolit në shtetet jo islame; Dispozita e pirjes së alkoolit në ligjet e Kosovës; Substancat narkotike; Dispozita e përdorimit të narkotikëve në kohën bashkëkohore; Dispozita e përdorimit të narkotikëve në ligjet e Kosovës; Substancat narkotike mes shariatit Islam dhe ligjit të Kosovës.

Literatura: (fq. 1/203-252)

Java e gjashtë: Vjedhja, përkufizimi i vjedhjes, urtësitë e ndëshkimit për vjedhje, kushtet e plotësimit të kësaj vepre penale, mesele të ndryshme të vjedhjes, vërtetimi i vjedhjes; Dënimi për vjedhje te hebrenjtë dhe të krishterët; Dënimi për vjedhje në ligjet e Kosovës; Vjedhja mes shariatit Islam dhe kanuneve të ndryshme.

Literatura: (fq. 1/256-300)

Java e shtatë: Vjedhja e madhe, *plaçkitja*. Përkufizimi i vjedhjes së madhe, dispozitat e plaçkitjes, vërtetimi i kësaj vepre penale, kushtet e plotësuara, mesele të ndryshme rreth plaçkitjes; Masat ndëshkuese për plaçkitje te hebrenjtë, të krishterët, ligjet e Kosovës dhe në shariatin Islam.

Literatura: (fq. 1/307-341)

Java e tetë: Rebelimi, përkufizimi i rebelimit, *el-bag-ju*, qasja e organeve shtetërore karshi rebelëve, masat ndëshkuese ndaj tyre tek hebrenjtë, të krishterët, ligjet e Kosovës dhe në shariatin Islam; Dalja nga feja, përkufizimi i renegatëve, *err-rrid-detu*, kushtet e renegatëve, dispozita e daljes nga feja; Dënimi për dalje nga feja te hebrenjtë dhe të krishterët; Braktisja e fesë në ligjet e Kosovës.

Literatura: (fq. 1/347-399)

Java e nëntë: Veprat penale të vrasjes; Përkufizimi i vrasjes, llojet e vrasjeve; Vrasja e qëllimshme, kushtet e vrasjes së qëllimshme, mënyra e vërtetimit të vrasjes së qëllimshme, ndëshkimet për vrasjen e qëllimshme, çështje të ndryshme rreth vrasjes së qëllimshme; Ndëshkimet zëvendësuese: *dija, teaziri*; Ndëshkimet pasuese: *privimi nga trashëgimia, privimi nga testament*.

Literatura: (fq. 2/7-121)

Java e dhjetë: Vrasja e ngjashme me të qëllimshmen; Përkufizimi, kushtet, vërtetimi i vrasjes së ngjashme me të qëllimshmen; Ndëshkimet e vrasjes së ngjashme me të qëllimshmen; Lloji i parë: ndëshkimet *parësore*; lloji i dytë: ndëshkimet *zëvendësuese*; lloji i tretë: ndëshkimet *pasuese*; Hakmarrja mes shariatit Islam dhe kanuneve të ndryshme.

Literatura: (fq. 2/129-172)

Java e njëmbëdhjetë: Vrasja e paqëllimshme – *e gabuar*. Përkufizimi dhe llojet e vrasjes së paqëllimshme; Kushtet dhe vërtetimi i vrasjes së paqëllimshme; Ndëshkimet dhe çështje të ndryshme rreth vrasjes së paqëllimshme; Vrasja e paqëllimshme mes shariatit Islam dhe kanuneve të ndryshme; Lëndimet trupore apo krimi ndaj gjymtyrëve të njeriut – *el-xhuruh*; Llojet e krimeve ndaj gjymtyrëve, vërtetimi dhe ndëshkimi i krimeve në gjymtyrë; Dispozita e hakmarrjes në gjymtyrë; Masat ndëshkuese të hebrenjtë, të krishterët, ligjet e Kosovës dhe në shariatit Islam.

Literatura: (fq. 2/175-280)

Java e dymbëdhjetë: Krimi ndaj embrionit dhe aborti; Mesele të ndryshme rreth embrionit; Aborti, çështje të ndryshme lidhur me abortin dhe ndëshkimi për abortin në legjislacionet e mëparshme, ligjet e Kosovës dhe shariatit Islam; Përkufizimi i teazirit, ligjshmëria e teazirit, dispozita e teazirit, sasia dhe vërtetimi i teazirit; Llojet e ndëshkimeve me teazir; Teaziri të hebrenjtë, të krishterët, në ligjet e Kosovës dhe në shariatit Islam.

Literatura: (fq. 2/283-380)

Java e trembëdhjetë: Betimi *el-ejman*; Llojet e betimeve; Zotimi *en-nedhr*; Imponimi *el-ekrah*; Dispozita të ndryshme lidhur me këto çështje.

Java e katërbëdhjetë: Kurbanit *el-udhijetu*; Kushtet e therrjes së kurbanit; Kushtet që duhet t'i plotësojë kafsha për kurban; Çka lejohet të prehet për kurban; Dispozita të ndryshme lidhur me çështjen e kurbanit; Gjuetia dhe therrja *es-sajh ve edh-dhebah*; Kuptimi etimologjik dhe terminologjik i gjuetisë; Norma e gjuetisë; Kushtet që cilat duhet t'i plotësojë gjuetia për të qenë hallall; Kushtet që duhet t'i plotësojë mjeti i gjahut dhe dispozita të ndryshme.

Java e pesëmbëdhjetë: Provimi final.

Kriteriumi dhe komponentët e vlerësimit:

Pjesëmarrja dhe aktiviteti gjatë orës: **10 pikë**

Vlerësimi i testit të parë: **20 pikë**

Vlerësimi i testit të dytë: **20 pikë**

Provimi final **50 pikë**

Totali: **100 pikë**

Literatura obliguese:

Dr. Shefqet Krasniqi, *E drejta Penale Në Sheriatin islam, studime krahasimore me legjislacionin hebre, të krishterë dhe ligjet e Kosovës*. Libër i botuar nga FSI-ja, i përgatitur enkas për studentët e FSI-së.

Literatura plotësuese:

Sejid Sabik, *Legjislacioni i traditës së Profetit*. Vëll. III. Mileniumi i Ri, Tiranë, 2007.

Wehebeh Zuhejl, *Al-Fiqh Al-Islami ve Adiletuhu*. Vëll. VIII. Dar el-Fikr, Liban, 2002

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

Studenti është i obliguar në vijimin e ligjëratave, ngase për secilën orë mbahet evidenca. Nga studentët kërkohet t'u përmbahen rregullave dhe kodit të mirësjelljes.

Konsultimet:

Orët e konsultimeve mbahen në kabinet sipas orarit të dhënë dhe mund të shfrytëzohet për ndihmë për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me lëndën.